

POLITIKA PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT

DAK-PO-09

MIRATUAR NGA,
DREJTORE E PËRGJITHSHME
Gentiana ISLAMAJ

PËRMBAJTJA

1. FUSHA.....	3
2. REFERENCAT.....	3
3. PËRGJEGJËSITË.....	3
4. FJALORI DHE SHKURTESAT.....	3
4.1 Fjalori	3
4.2 Shkurtesat.....	3
5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS.....	4
5.1 Identifikimi i rreziqeve	4
5.2 Analiza e rreziqeve.....	4
5.3 Vlerësimi i rreziqeve	4
5.4 Trajtimi dhe monitorimi i rreziqeve	6
6. ANEKSET.....	6
7. REGJISTRAT.....	6
8. HISTORIA.....	6

1. FUSHA

Kjo politikë përshkruan identifikimin, analizimin, vlerësimin, trajtimin, monitorimin dhe dokumentimin e rreziqeve ndaj paanshmërisë që dalin nga aktivitetet e DAK-së.

2. REFERENCAT

ISO/IEC 17011:2017 Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për trupat e akreditimit që akreditojnë trupat për vlerësimin e konformitetit.

3. PËRGJEGJËSITË

Kjo politikë zbatohet për personelin e brendshëm dhe të jashtëm të DAK-së të përfshirë në akreditim (siç janë stafi i brendshëm i DAK-së, KP, KA, KT, vlerësuesit dhe ekspertët).

4. FJALORTHË DHE SHKURTESAT

4.1 Fjalorthi

Për qëllimin e kësaj politike, zbatohen termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017.

4.2 Shkurtesat

KA	Këshilli i Akreditimit
TVK	Trupi për Vlerësim të Konformitetit
DAK	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës
EA	European Accreditation (Bashkëpunimi Evropian për Akreditim)
ILAC	International Laboratory Accreditation Council (Këshilli Ndërkombëtar për Akreditimin e Laboratorëve)
KP	Këshilli Profesional
KT	Komiteti Teknik

5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS

5.1 Identifikimi i rreziqeve

DP në bashkëpunim me KP identifikojnë rreziqet që lidhen me paanshmërinë dhe që burojnë nga aktivitetet e DAK-së, në janar të çdo viti.

Burimet për identifikimin e rreziqeve që lidhen me paanshmërinë janë:

- a) Organizimi, struktura e DAK-së
- b) Trupat e ndërlidhur (organizma nën përgjegjësinë e ministrive)
- c) Paanshmëria e personelit të DAK përfshirë personelin e brendshëm të DAK-së, anëtarët e KP, KA dhe KT, dhe vlerësuesve dhe ekspertëve.
- d) Financat e DAK-së
- e) Sigurimi i trajnimit për TVK-të
- f) Pjesëmarrja në projekte
- g) Rreziqet e mbetura

Burimet për identifikimin e rreziqeve që lidhen me aktivitetet e DAK-së janë:

- Auditimet e brendshme
- Rishikimi i menaxhimit
- Jokonformitetet e gjetura në sistemin e menaxhimit dhe aktivitetet e DAK-së
- Vlerësimi kolegjial
- Informacione nga personeli i DAK-së
- Ankesat dhe apelimet
- Rreziqet e mbetura nga vlerësimi i mëparshëm
- Burimet

Identifikimi i rreziqeve regjistrohet në formularin PO-09-Shtojca 2.

5.2 Analiza e rreziqeve

Për takimin e rregullt të KP dhe/ose kur identifikohet një rrezik, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës nga identifikimi, DP, MC dhe DDZHA kryejnë një analizë të shkakut rrënjësor të rrezikut dhe ndikimit të rrezikut në aktivitetet e DAK-së në formularin PO-09-Shtojca 2. Analiza e shkakut rrënjësor paraqitet në takim tek KP për vlerësim.

5.3 Vlerësimi i rreziqeve

KP në takimin e tij vlerëson të gjitha rreziqet, duke përdorur metodën e mëposhtme të klasifikimit:

Faktorët për klasifikim janë:

- a) Gjasat e shfaqjes (A)
- b) Ndikimi/pasoja në paanshmëri/aktivitet (B)

Klasifikimi është:

- Asnjë ose shumë e ulët (0): gjasa e shfaqjes - efekti/pasoja/ndikimi në aktivitetet ose paanshmërinë e DAK-së
- E ulët (1): gjasa e shfaqjes - efekti/pasoja/ndikimi në aktivitetet ose paanshmërinë e DAK-së (p.sh. kontrolli i dokumenteve, informacioni)
- Mesatare (2): gjasa e shfaqjes - efekti/pasoja/ndikimi në aktivitetin ose paanshmërinë e DAK-së (p.sh. buxheti, çështjet financiare, pjesëmarrja në komitetet e EA)
- Gjasa e lartë (3) e shfaqjes- efekti/pasoja/ndikimi në aktivitetet ose paanshmërinë e DAK-së (p.sh. mungesa e kompetencës së personelit, përfshirë vendimmarrësit, mungesa e paanshmërisë së personelit, përfshirë vendimmarrësit dhe anëtarët e komitetit teknik, mospërbushja e kërkesave të ISO/IEC 17011:2017 ose legjislacionit në lidhje me akreditimin ose dokumentet e detyrueshme të EA dhe ILAC, etj.)

Niveli i rrezikut është shumëzimi i 2 faktorëve, d.m.th niveli i rrezikut = A x B.

		Efekti/Pasoja (B)			
		Asnjë/shumë e ulët (0)	I ulët (1)	Mesatar (2)	I lartë (3)
Gjasa e shfaqjes (A)	Asnjë/shumë e ulët (0)				
	E ulët (1)				
	Mesatare (2)				
	E lartë (3)				

Vlerësimi i rrezikut:

Niveli i rrezikut		Veprimi
≥6	I papranueshëm	Kërkohet veprim i menjëhershëm
2-4	I pranueshëm	Mund të kërkohet veprim
≤ 1	Asnjë rrezik ose shumë e ulët	Nuk kërkohet asnjë veprim

Vlerësimi regjistrohet në formularin PO-09-Shtojca 2.

5.4 Trajtimi dhe monitorimi i rreziqeve

Për secilin rrezik të identifikuar, bazuar në analizën e shkaqeve rrënjësore, KP rekomandon veprime për përmirësime të cilat duhet të merren në mënyrë që të eliminohet ose minimizohet rreziku. DP me përfshirjen e MC dhe DDAZH, bazuar në rekomandimin e KP, vendos mbi veprimet për përmirësime, personin(at) përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve dhe afatin kohor për realizimin e veprimeve në formularin PO-09-Shtojca 2.

Kur niveli i rrezikut vlerësohet i papranueshëm, atëherë DP vendos për pezullimin e aktiviteteve derisa rreziku të zbutet në një nivel të pranueshëm. Nëse rreziku nuk mund të zbutet në një nivel të pranueshëm, akreditimi nuk do të sigurohet nga DAK.

Të gjitha veprimet e ndërmarra regjistrohen në formularin PO-09-Shtojca 2. Pas mbarimit të afatit kohor, DP kontrollon veprimet e kryera dhe KP rivlerëson nivelin e secilit rrezik sipas pikës 5.3 të kësaj politike. Rivlerësimi i rreziqeve regjistrohet në formularin PO-09-Shtojca 2.

6. ANEKSET

PO-09-Shtojca 1 Analizat e rrezikut 2016

PO-09-Shtojca 2 Shablloni i analizës së rrezikut

7. REGJISTRAT

Nuk aplikohet

8. HISTORIA

Data e botimit	Përgatitur nga	Përshkrimi i ndryshimeve të aplikuara
16.05.2019	Ardiana Krrabaj	Dokument i ri
15.11.2019	Valmira Sejdiu	Rishikim i plotë në përputhje me ISO/IEC 17011:2017 dhe DAK-PM-01

